


REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA NOTERISE KAVAJE

Noter Frederik Tengu

Nr. 2964 Rep. 1599 Kol



KONTRATE SHITBLERJE
TE KUOTAVE TE SHOQERISE "ERGI" shpk

Sot me date 10 Shtator 2018 (Dymije e tetembehjete) ditën e Hënë në zyrën e noterisë kavaje, para meje noter Frederik Tengu, i regjistruar në dhomen e noterisë Durrës-Kavaje, me seli pranë Bashkisë Kavaje, u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

SHITESI: **SKËNDER RROSHI** i biri i Selman dhe Hatixhe, i dt.29.08.1949, lindur e banues në Kavaje, identifikuar me kartë identiteti me nr.026539845, nr.personal E90829065L.

BLERESI: **GENTIAN DAJA** i biri i Tahir dhe Mukades, i dt.19.07.1976, lindur e banues në Kavaje, identifikuar me kartë identiteti me nr.027924351, nr.personal H60719076T.

Te mesipërmit janë madhore e me zotesi të plote juridike e për të vepruar të cilet me vullnetin e tyre të lire, kerkuan redaktimin e këtij akti në përputhje me nenin 705 e vijues të K.Civil si dhe ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 "Për Tregetaret dhe Shoqëritë Tregetare" nën 73 pika "b" me objekt:

Shtetesi **SKËNDER RROSHI** që paraqitet me cilesinë e shitesit është ortak në shoqërinë cituar me sipër se bashku me ortakun tjetër bleresin e mesipërmit, dhe përkatësisht:

- ka në zotërim 50 % të pjesëve të kapitalit të shoqërisë „ERGI“ shpk shoqëri e regjistruar me Nr.Nipti K72522812K, referuar sipas ekstraktit të regjistrimit të QKB.

Disponuesi shtetasi **SKËNDER RROSHI** në bazë të vendimit të marrë në mbledhjen asamblese të kësaj shoqërie të datës 03.09.2018 ka vendosur dhe pranuar shitjen e pjesëve që zoteron sipas përcaktimit cituar me sipër, me zotërim total 50 % të pjesëve të kapitalit të kësaj shoqërie, që janë në disponim të tij

Lidhur me këtë çështje shitesit **SKËNDER RROSHI** DEKLAROI në prezencën time noterit, SE pjesët e tij që disponon në këtë shoqëri SI ME SIPER PERCAKTUAR me vullnet të lire e të plote se IA SHET shtetesi **GENTIAN DAJA** i cili ka pranuar blerjen e e këtyre pjesëve të kapitalit të shoqërisë së thjeshtë "ERGI" shpk

Kjo shitje është e bazuar dhe në përputhje të plote edhe me vendimin e Asamblese së oratkeve të kësaj shoqërie, vendim si me sipër cituar, bashkangjitur.

Cmimi i shitjes dhe blerjes së këtyre pjesëve të kapitalit të kësaj shoqërie është caktuar në marrëveshje të përbashkët të palëve respektivisht:

- pjesa me zotërim 50 % e pjesëve të kapitalit të shitesit disponuesit Skender Rroshi në vlerën 150.000 leke të reja.

Kjo vlerë totale prej 150.000 leke të reja është likujduar plotësisht nga bleresi në favor të palës shitesë, likujdim i kryer jashtë kësaj zyre, ku ortakët i shoqërisë Skender Rroshi deklarën se e ka marrë në dorezim vlerën e cituar më lart.

Shitesit me kryerjen e këtij likujdimi, zhvishet nga disponimi i pjesës së tij zotëruar të kapitalit të kësaj shoqërie me zotërim total 50 % të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, dhe të drejtat e disponimit të tyre kalojnë tek bleresi shtetesi **GENTIAN DAJA** i cili se bashku me pjesën e tij që disponon në këtë shoqëri fiton disponimin e tij të plote me zotërim 100 % të pjesëve të kapitalit të kësaj shoqërie, (në të cilën ai aktualisht është disponues e 50 %) të pjesëve të kapitalit të kësaj shoqërie, DUKE U BERE ORTAK LVETEM I

Skender Rroshi

Gentian Daja

GENTIAN DAJA

SHOQERISE, duke mbartur gjithashtu te gjitha te drejtat dhe detyrimet me kete cilesi si ortak i vetem i shoqerise.

Ortaku shites me nenshkrimin e ketij akti nuk ka asnje te drejte dhe nderkohe asnje obligim nga kjo date ne lidhje me kete shoqeri.

Une noteri vertetova rregullisht aktet perkatese te siper cituara qe legjitimojne palet, akte bashkangjitur kontrates, vertetova pohimin e paleve per likujdimin e bere, dhe vullnetin e tyre per sa me siper.

Kontrata iu lexua paleve, u kuptua dhe pranua nga ta, dhe nenshkruhet rregullisht ne pranine time nga secili personalisht me vullnet te lire e te plote.

Une noteri vertetova rregullisht per sa me siper.

SHITESI

Skander Rroshi


BLERESI

GENTIAN GAGA


NOTER

FREDERIK TENGU

